



VENDIM

KOMITETI DREJTUES I DHOMES TE AVOKATISE TE SHQIPERISE

Komiteti Drejtues i Dhomes se Avokatise te Shqiperise, percjell me shume shqetesim ngjarjen lidhur me vrasjen e Gjyqtarit te Gjykates se Apelit te Juridiksionit te Pergjithshem, Z.Astrit KALAJA, si ngjarja me e rende dhe e paprecedent e ndodhur ndonjehere ne sistemin e drejtesise.

Komiteti Drejtues i Dhomes se Avokatise te Shqiperise vendosi njezeri qe te bojkotoj te gjitha proceset hetimore dhe ato gjyqesore, per ceshtjet penale, civile dhe administrative, ne te gjitha nivelet e gjykimit, **per datat 9 dhe 10 Tetor 2025.**

Ky bojkot eshte nje thirrje per te gjithë opinionin, politiken shqiptare, Keshillin e Larte Gjyqesor, Keshillin e Larte te Prokurorise, Inspektorin e Larte te Drejtesise, si dhe palet ndergjygjese, qe te angazhohen me pergjegjesine maksimale per sigurimin e jetes dhe shendetit, si dhe te veprimtarise dhe aktivitetit te gjyqtareve, prokuroreve, dhe avokateve ne ushtrimin e detyrave te tyre ne realizimin dhe funksionimin e drejtesise.

Ky vendim nuk i shtrin efektet e tij per masat e sigurimit ne procesin penal.

Urdherohen te gjithë kryetaret e Dhomave Vendore te Avokatise per ekzekutimin e ketij vendimi.

KRYETARI

Prof. Dr. Maksim HAXHIA

